**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2026**

Periudha ( Janar 2026 )

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 | 13.01.2026 | 1.A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2025?<br>2.Nëse keni ofruar mbështetje financiare, sa ka qenë buxheti i shtetit i alokuar vetëm për mbështetjen e organizatave jofitimprurëse gjatë vitit 2025? Sa nga ky buxhet u disbursua tek OJF-të?<br>3. Nëse keni ofruar mbështetje financiare cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?<br>4.Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2025? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë së një formë.<br>5.Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë se një formë.<br>6.Cila ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.<br>7.Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2025? Cila është baza ligjore/ rregullatore që | 23.01.2026 | 1.Po, kemi ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2025.<br>2.Buxheti i shtetit i alokuar vetëm për mbështetjen e OJF-ve për vitin 2025, ka qenë 300 000 mijë lekë, nga ky buxhet u disbursua 0% tek OJF-të.<br>3.Forma e mbështetjes financiare, ka qenë forma e mbështetjes grant.<br>4.Gjatë vitit 2025 ka aplikuar vetëm një OJF për mbështetje financiare, forma e mbështetjes grant.<br>5.Nga kjo mbështetje nuk ka përfituar asnjë OJF.<br>6.Buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total, ka qenë zero.<br>7.Po, bashkia Belsh ka ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2025, baza ligjore /rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje është, ligji nr.139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.<br>8.Nga kjo mbështetje kanë përfituar dy OJF, Forumi i Gruas Elbasan dhe Shoqata “Në dobi të femrës, komuniteteve, shtresave në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar”. Lloji i | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rregullon këtë formë mbështetjeje?<br>8.Nëse keni ofruar mbështetje jofinanciare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 9.Keni nënshkruar kontratë për mbështetje jo financiare? Nëse po, cila është baza ligjore për ofrimin e kësaj mbështetjeje?<br>10.Cili është numri i takimeve monitoruese nga numri total i projekteve fituese që keni kryer gjatë 2025? Ju lutem na siguroni një listë të kritereve monitoruese.<br>11.A është bërë një vlerësim impakti mbi fondin e disbursuar ndaj organizatave jofitimprurëse? A keni një raport të tillë vlerësimi? Nëse po, ju lutem bashkëngjisni atë.<br><br>Bashkëpunimi me OJF-të:<br>1.Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2025?<br>2.A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.<br>3.Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj? Si janë informuar ato?<br>4.Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë konsultuar me OJF-të?<br>5. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në | | mbështetjes ka qenë ofrimi i mjediseve, shkëmbimi i eksperiencave.<br>9.Është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi midis Bashkisë Belsh dhe Shoqatës "Në dobi të femrës, komuniteteve, shtresave në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar".<br>10.Për sa i përket takimeve me këto OJF janë bërë 7 takime, por nuk kanë qenë takime monitoruese nga ana jonë.<br>11.Jo, nuk është bërë një vlerësim impakti mbi fondin e disbursuar ndaj OJF.<br><br>Bashkëpunimi me OJF-të:<br>1.Numri i konsultimeve publike të bëra gjatë vitit 2025, ka qenë dy.<br>2.Përsa i përket pikave 2,3,4,5,6 përgjigjja është, jo. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse Po, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to?<br>6.A janë përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj? Nëse Po, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to? | | | | |